



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

16/12/2020

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____.2020

PËR

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR SHPALLJEN E
GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 40, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Gjendja e fatkeqësisë natyrore mund të shpallet në një pjesë të territorit ose në të gjithë vendin.
2. Gjendja e fatkeqësisë natyrore shpallet kur, me mundësitë dhe burimet që zotërohen në kushte normale nga njësitë e qeverisjes vendore ose organet e administratës publike, nuk mund të përballohen pasojat e shkaktuara nga fatkeqësia.
3. Shpallja e gjendjes së emergjencës, klasifikimi i llojit të saj do të varet nga faktorët e listuar më poshtë:
 - a) shtrirja territoriale e zonës së dëmtuar ose të prekur, sipas rastit;
 - b) ndikimet e këtyre dëmeve në prishjen e ekuilibrave të jetës normale të komunitetit;
 - c) të dhënat shkencore nga institutet/strukturat përkatëse, për rastin konkret të fatkeqësisë.
4. Gjendja e fatkeqësisë natyrore shpallet për dukuri natyrore ekstreme dhe fatkeqësi të tjera, si më poshtë:
 - a) Për tërmetet, të dhënat e para jepen brenda 2 orëve dhe në mënyrë periodike, për vijueshmërinë e goditjeve sizmike, dëmet e shkaktuara në humbje të jetëve njerëzore, banesa dhe dëme të tjera infrastrukturore, deri në shuarjen përfundimtare të goditjeve sizmike;

- b) Për përmbytjet dhe vërshimet e ujit, që vijnë si rezultat i rritjes në nivele kritike të ujit, nga faktorë gjeologjikë, atmosferikë apo njerëzorë, në shtratin e lumenjve, në nivelin e liqeneve apo në batica bregdetare, duke mbuluar përkohësisht me ujë sipërfaqe toke në atë nivel që të përbëjnë rrezik për njerëzit, banesat dhe infrastrukturën;
- c) Temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, kur këto shkaktojnë dëme serioze në jetën dhe shëndetin e njerëzve, edhe në pasuritë e tyre;
- ç) Rrëshqitjet arkitektonike, të shkaktuara drejtpërdrejt nga një ngjarje tërmeti apo nga dukuri të tjera gjeologjike, të cilat kanë shkaktuar humbje të jetëve njerëzore, gjësë së gjallë ose dëme në banesa dhe infrastrukturë;
- d) Për ortekët e formuar nga dëbora e akumuluar dhe e paqëndrueshme, në terrene të pjerrëta mjaftueshëm (mbi 30°), rënia e të cilëve ka shkakuar dëme të konsiderueshme në njerëz dhe gjënë e gjallë ose bllokim të rrjetit të infrastrukturës kritike;
- dh) Për erërat e forta në tokë dhe në det, kur ato zgjasin në kohë dhe në hapësirë, duke sjellë probleme për transportin rrugor dhe atë detar, duke u shoqëruar me rrëzime të pemëve, objekteve apo strukturave të ndryshme, me rrezik për aksidente, gjymtime dhe dëme të pronës dhe me raste, kërcënim të jetës;
- e) Për zjarret masive në pyje apo në zona të populluara, kur ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë të flakëve, në zonat e ekspozuara, duke kërcënuar jetën e njeriut, pronën dhe gjënë e gjallë, shoqëruar me temperatura të larta dhe erëra të forta, duke bërë edhe kontrollin e tyre shumë të vështirë;
- ë) Për sëmundjet infektive masive, të cilat mund të jenë: epidemike që prekin shumë persona në të njëjtën kohë dhe që përhapen nga personi në person, në një lokalitet të kufizuar, ku sëmundja nuk është tipike e zonës; pandemike, e cila është një epidemi që përhapet në shkallë më të gjerë dhe që paraqet rrezik të konsiderueshëm shëndetësor, me potencial për ndikim të pafavorshëm ekonomik dhe shqetësim publik;
- f) Për aksidentet teknologjike që vijnë si rezultat i sulmeve terroriste, problemeve teknike të pajisjeve prodhuese, dështimeve teknike, kompleksitetit të tepërt të procesit të prodhimit, gabimeve në projektim dhe prodhim, zhvlerësimit të pajisjeve, mjeteve të vjetruara të prodhimit, gabimeve apo dëmtimeve me dashje të personelit, keqkuptimeve për veprimet e përbashkëta të profesionistëve, faktorë të jashtëm etj., kur këto shkaktojnë dëme serioze në jetën, shëndetin e njerëzve dhe në pasuritë e tyre;
- g) Për aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, ajrore që vijnë si rezultat i dështimeve, gabimeve njerëzore, dobësive të thella strukturore të vetë mjeteve, teknikës apo infrastrukturës së tyre, ose faktorë të jashtëm, të cilat shkaktojnë dëme serioze në jetën, shëndetin e njerëzve dhe në pasuritë e tyre;
- gj) Për aksidentet bërthamore ekologjike ose industriale që vijnë si rezultat i zhvillimeve të pakontrolluara të ciklit të prodhimit nga operatorë të ndryshëm apo ndërmarrjeve, kur këto çlirojnë një numër të madh substancash, rrezatimesh, me një shkallë të lartë toksiciteti, por edhe të paqëndrueshme, të lëshuar me shpejtësi në atmosferë/mjedis dhe që çon në rrezik serioz, të menjëhershëm apo të vonuar, për shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

16/12/2020

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. 2020

PËR

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR SHPALLJEN E
GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 40, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Gjendja e fatkeqësisë natyrore mund të shpallet në një pjesë të territorit ose në të gjithë vendin.
2. Gjendja e fatkeqësisë natyrore shpallet kur, me mundësitë dhe burimet që zotërohen në kushte normale nga njësitë e qeverisjes vendore ose organet e administratës publike, nuk mund të përballohen pasojat e shkaktuara nga fatkeqësia.
3. Shpallja e gjendjes së emergjencës, klasifikimi i llojit të saj do të varet nga faktorët e listuar më poshtë:
 - a) shtrirja territoriale e zonës së dëmtuar ose të prekur, sipas rastit;
 - b) ndikimet e këtyre dëmeve në prishjen e ekuilibrave të jetës normale të komunitetit;
 - c) të dhënat shkencore nga institutet/strukturat përkatëse, për rastin konkret të fatkeqësisë.
4. Gjendja e fatkeqësisë natyrore shpallet për dukuri natyrore ekstreme dhe fatkeqësi të tjera, si më poshtë:
 - a) Për tërmetet, të dhënat e para jepen brenda 2 orëve dhe në mënyrë periodike, për vijueshmërinë e goditjeve sizmike, dëmet e shkaktuara në humbje të jetëve njerëzore, banesa dhe dëme të tjera infrastrukturore, deri në shuarjen përfundimtare të goditjeve sizmike;

- b) Për përmbytjet dhe vërshimet e ujit, që vijnë si rezultat i rritjes në nivele kritike të ujit, nga faktorë gjeologjikë, atmosferikë apo njerëzorë, në shtratin e lumenjve, në nivelin e liqeneve apo në batica bregdetare, duke mbuluar përkohësisht me ujë sipërfaqe toke në atë nivel që të përbëjnë rrezik për njerëzit, banesat dhe infrastrukturën;
- c) Temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, kur këto shkaktojnë dëme serioze në jetën dhe shëndetin e njerëzve, edhe në pasuritë e tyre;
- ç) Rrëshqitjet arkitektonike, të shkaktuara drejtpërdrejt nga një ngjarje tërmeti apo nga dukuri të tjera gjeologjike, të cilat kanë shkakuar humbje të jetëve njerëzore, gjësë së gjallë ose dëme në banesa dhe infrastrukturë;
- d) Për ortekët e formuar nga dëbora e akumuluar dhe e paqëndrueshme, në terrene të pjerrëta mjaftueshëm (mbi 30°), rënia e të cilëve ka shkakuar dëme të konsiderueshme në njerëz dhe gjënë e gjallë ose bllokim të rrjetit të infrastrukturës kritike;
- dh) Për erërat e forta në tokë dhe në det, kur ato zgjasin në kohë dhe në hapësirë, duke sjellë probleme për transportin rrugor dhe atë detar, duke u shoqëruar me rrëzime të pemëve, objekteve apo strukturave të ndryshme, me rrezik për aksidente, gjymtime dhe dëme të pronës dhe me raste, kërcënim të jetës;
- e) Për zjarret masive në pyje apo në zona të populluara, kur ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë të flakëve, në zonat e ekspozuara, duke kërcënuar jetën e njeriut, pronën dhe gjënë e gjallë, shoqëruar me temperatura të larta dhe erëra të forta, duke bërë edhe kontrollin e tyre shumë të vështirë;
- ë) Për sëmundjet infektive masive, të cilat mund të jenë: epidemike që prekin shumë persona në të njëjtën kohë dhe që përhapen nga personi në person, në një lokalitet të kufizuar, ku sëmundja nuk është tipike e zonës; pandemike, e cila është një epidemi që përhapet në shkallë më të gjerë dhe që paraqet rrezik të konsiderueshëm shëndetësor, me potencial për ndikim të pafavorshëm ekonomik dhe shqetësim publik;
- f) Për aksidentet teknologjike që vijnë si rezultat i sulmeve terroriste, problemeve teknike të pajisjeve prodhuese, dështimeve teknike, kompleksitetit të tepërt të procesit të prodhimit, gabimeve në projektim dhe prodhim, zhvlerësimit të pajisjeve, mjeteve të vjetruara të prodhimit, gabimeve apo dëmtimeve me dashje të personelit, keqkuptimeve për veprimet e përbashkëta të profesionistëve, faktorë të jashtëm etj., kur këto shkaktojnë dëme serioze në jetën, shëndetin e njerëzve dhe në pasuritë e tyre;
- g) Për aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, ajrore që vijnë si rezultat i dështimeve, gabimeve njerëzore, dobësive të thella strukturore të vetë mjeteve, teknikës apo infrastrukturës së tyre, ose faktorë të jashtëm, të cilat shkaktojnë dëme serioze në jetën, shëndetin e njerëzve dhe në pasuritë e tyre;
- gj) Për aksidentet bërthamore ekologjike ose industriale që vijnë si rezultat i zhvillimeve të pakontrolluara të ciklit të prodhimit nga operatorë të ndryshëm apo ndërmarrjeve, kur këto çlirojnë një numër të madh substancash, rrezatimesh, me një shkallë të lartë toksiciteti, por edhe të paqëndrueshme, të lëshuar me shpejtësi në atmosferë/mjedis dhe që çon në rrezik serioz, të menjëhershëm apo të vonuar, për shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin;

- h) Rrëzimet e digave të shkaktuara drejtpërdrejt nga një ngjarje tërmeti, nga amortizimi në vite, ndryshimi i kushteve klimatike etj., që sjellin si pasojë përmbytje masive, të cilat shkaktojnë dëme serioze në jetën, shëndetin e njerëzve dhe në pasuritë e tyre, si dhe kolaps në ekonomi;
- i) Për dukuri natyrore ekstreme apo fatkeqësi të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.
5. Institucionet, institutet dhe strukturat kryesore të ngarkuara për dhënien e informacionit dhe vlerësimin paraprak të dëmeve për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore janë:
- ministritë sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore apo të kompetencave që kanë lidhje me dukurinë natyrore apo fatkeqësitë e tjera;
 - institutet/strukturat shtetërore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e shkallës së fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësitë e tjera;
 - prefekti i qarkut;
 - bashkia në territorin e së cilës ndodh fatkeqësia.
6. Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, kur sigurohen të dhënat, sipas pikës 3 të këtij vendimi, ndiqen këto procedura:
- a) Në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, nga momenti që ndodh një fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi tjetër, dërgohen raporte me të dhëna nga autoritetet, e listuara më poshtë:
- Institucionet, institutet dhe strukturat shtetërore përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e intensitetit të fatkeqësisë, të cilat, në varësi të llojit të fatkeqësisë, dërgojnë të dhënat e para të regjistruara në mënyrë periodike, plotësojnë këto të dhëna përgatisin raporte deri në shuarjen e plotë të aktivitetit të fatkeqësisë;
 - Prefekti i qarkut dhe kryetari i bashkisë, për gjendjen e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia në territorin e përgjegjësisë së tyre;
- b) Raporti i vlerësimin paraprak të dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësia, i dërguar nga kryetari i bashkisë dhe prefekti i qarkut, shoqërohet me kërkesë për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore;
- c) Me marrjen e të dhënave dhe kërkesës, sipas shkronjës "a" dhe "b", të pikës 6 të këtij vendimi, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile analizon dhe vlerëson të dhënat dhe paraqet raportin e situatës dhe, sipas rastit, i propozon ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore;
- ç) Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile, vendos shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë në të gjithë territorin ose për një pjesë të territorit të vendit.
7. Nisma për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore për rastet sipas pikës 10, të nenit 3, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", ndërmerret nga ministritë e linjës, sipas veçorive që shfaqen, si dhe fushës së përgjegjësisë shtetërore apo kompetencave që

mbulojnë, në bashkëpropozim me ministrin përgjegjës për mbrojtjen civile, bazuar në informacionin e marrë nga institutet/strukturat shtetërore përkatëse dhe organet e vetëqeverisjes vendore të prekura nga fatkeqësia.

8. Ngarkohen të gjitha ministritë, institutet kërkimore e shkencore, të përmendura në pikën 5 të këtij vendimi, entet publike, sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore që mbulojnë për mbrojtjen civile, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, për zbatimin e këtij vendimi.
9. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 664, datë 18.12.2002 "Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim përcakton kriteret dhe procedurat për shpalljen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë territorin ose në një pjesë territori të Republikës së Shqipërisë, kur fatkeqësia natyrore ka ndikuar ekuilibrat e jetës normale të njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisin. Projektvendimi përcakton të dhënat (kriteret) dhe procedurat për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Nëpërmjet projektvendimit shfuqizohet vendimi nr. 664, datë 18.12.2002, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile”, i cili deri më tani ka shërbyer si dokument bazë për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike.

Projektvendimi është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2020.

Projektvendimi është një detyrim ligjor që rrjedh nga pika 3, e nenit 40, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim është i domosdoshëm, pasi nëpërmjet tij do të vendosen kriteret dhe procedurat për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, me qëllim menaxhimin e pasojave që krijohen nga këto fatkeqësi për të cilat, me mundësitë dhe burimet që zotërohen në kushte normale nga autoritetet e sistemit të mbrojtjes civile, nuk mund të përballohen pasojat e shkaktuara nga fatkeqësia

Projektvendimi përcakton bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe strukturave të sistemit të mbrojtjes civile dhe institucioneve, instituteve dhe strukturave që në fushën e përgjegjësisë së tyre shtetërore kanë kompetenca për monitorimin e dukurive natyrore, vlerësimin shkencor të tyre dhe japin ekspertizë të specializuar nga momenti kur fatkeqësia

natyrore fillon, vazhdon aktivitetin e saj deri në shuarjen e aktivitetit (dukurive natyrore) që shkaktojnë pasoja serioze për komunitetin dhe cenon sigurinë e tij.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Aktualisht vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 664, datë 18.12.2002 “Për kriteret dhe procedurat e shpalljes e gjendjes së emergjencës civile”, përcakton kriteret dhe procedurat për shpalljen e së emergjencës civile, ky vendim i Këshillit të Ministrave ka dalë në bazë të ligjit nr. 8756, datë 23.3.2001 “Për emergjencat civile”.

Me miratimin e ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8756, datë 23.3.2001 “Për emergjencat civile”, është detyrim ligjor nxjerrja e aktit nënligjor, për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Pika nr. 3, e nenit 40, të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile” autorizon miratimin e një vendimi të këshillit të Ministrave ku përcaktohen kriteret dhe procedura për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet shpallja e fatkeqësisë natyrore për një pjesë të territorit apo në të gjithë territorin shtetëror, kjo në varësi të llojit të dukurive natyrore, ndikimi që japin dhe shtrirjes gjeografike.

Gjendja e fatkeqësisë natyrore (pika nr. 2) shpallet gjithmonë kur pasojat e ardhura për shkak të saj, nuk mund të përballohen me mundësi, kapacitete monetare, materiale dhe me burime njerëzore që zotërohen në kushte normale nga autoritetet, si bashkia, prefektura apo autoritetet qendrore shtetërore, në bazë të ligjit për mbrojtjen civile, kanë detyrim të ndërhyjnë dhe të marrin masa për zvogëlimin ose kufizimin e impakteve negative, rreziqeve, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve pronës, të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit.

Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore përcaktohen si kusht të dhënat (kriteret) e përgjithshme për të gjitha llojet e fatkeqësive natyrore, sipas të cilit dërgohet informacion për territorin e shtrirjes së aktivitetit të fatkeqësisë natyrore, informacion konkret mbi ndikimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e fatkeqësisë në prishjen e ekuilibrave të jetës normale të komunitetit dhe të dhënat shkencore nga institutet /strukturat përkatëse, për rastin konkret të fatkeqësisë.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”.

Pika nr. 4 e projektvendimit ka për qëllim të përcaktojë kritere konkrete në varësi të llojit të fatkeqësisë natyrore. Në projektvendim janë përshkruar kritere të cilat mund të përbëjnë shkak të shpalljes së fatkeqësisë natyrore për dukuritë natyrore apo për fatkeqësi të tjera, të përcaktuara sipas pikës nr. 9 dhe pikës 10, të nenit 3, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

Në projektvendim është përcaktuar si domosdoshmëri edhe përcaktimi i autoriteteve, të cilat japin informacion dhe vlerësim paraprak për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Ministritë, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore apo kompetencave që kanë për monitorimin, vlerësimin e dukurive të ndryshme natyrore që mund të shkaktojnë fatkeqësi natyrore, dërgojnë informacion dhe vlerësim paraprak për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Ky paragraf i pikës 5 të projektvendimit është në harmoni me shkronjën “d”, të pikës nr. 2, të nenit 22, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe sipas ligjit, në ministritë e linjës do të krijohen sektorët e mbrojtjes civile, të cilët do të jenë struktura që në kompetencë të tyre kanë mbrojtjen civile dhe informojnë, koordinojnë punën me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen civile.

Institutet/strukturat shtetërore, sipas projektvendimit, janë ato autoritete që, sipas nenit 46, të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, japin të dhënat paraprake për fatkeqësinë.

Prefekti i qarkut dhe kryetari i bashkisë do të informojnë Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për gjendjen e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore që ndodhin në territorin e përgjegjësisë së tyre.

Në pikën nr. 6 të projektvendimit përcaktohet procedura që ndiqen nga ndodhja e fatkeqësisë deri në shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Në shkronjën “a”, të pikës 6 të projektvendimit janë përcaktuar institucionet, institutet dhe strukturat që japin informacionet paraprake për fatkeqësinë. Ato raportojnë menjëherë në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në varësi të llojit të fatkeqësisë natyrore, vlerësojnë shkallën e fatkeqësisë. Këto struktura dërgojnë të dhëna në mënyrë periodike deri në shuarjen e aktivitetit të dukurisë apo ngjarjes.

Prefekti i qarkut dhe kryetari i bashkisë dërgojnë të dhëna për gjendjen e dëmeve që kanë ndodhur në territorin e përgjegjësisë së tyre nga fatkeqësia.

Në projektvendim është përcaktuar që prefekti i qarkut dhe kryetari i bashkësisë në dërgimin e të dhënave dhe raportit paraprak të vlerësimit të dëmeve, të paraqesin pranë AKMC-së edhe kërkesën për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore për territorin e tyre. Kjo kërkesë do shërbejë si indice për AKMC-në, për të vlerësuar të situatën në raport me të dhënat e dërguara nga të gjitha autoritetet përgjegjëse për marrjen e një vendimi, për të propozuar shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore te ministri përgjegjës për mbrojtjen civile.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, pasi i merr të dhënat e para nga strukturat sa më lart, pasi analizon të dhënat, paraqet raportin e situatës dhe sipas rastit propozimin për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore për ministrin përgjegjës për mbrojtjen civile.

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile, vendos për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për një pjesë të territorit ose të gjithë territorit në varësi të fatkeqësisë natyrore.

Në pikën nr. 7 të projektvendimit përcaktohet që, për fatkeqësitë e tjera, sipas pikës 12 dhe 10, të nenit 3, të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", propozimi për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në këto raste, ndërmerret nga ministritë e linjës, sipas llojit të fatkeqësisë, si dhe fushës së përgjegjësisë shtetërore apo kompetencave që mbulojnë, në bashkëpunim me institutet/strukturat shtetërore përkatëse dhe organet e vetëqeverisjes vendore, të prekura nga fatkeqësia. Shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sipas pikës nr. 7 të projektvendimit, bëhet në bashkëpropozim ndërmjet ministrisë së linjës dhe ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen civile.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi do të ngarkohen ministritë, institutet kërkimore e shkencore përkatëse, entet publike, që sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore që mbulojnë për mbrojtjen civile, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim institucioneve, si më poshtë:

Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Kulturës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk ka kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI I MBROJTJES

Olta Xhaçka